



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 164

Tiranë – E mërkurë, 4 dhjetor 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 754, datë 30.11.2019	Për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarëve për shkak të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, në strukturat akomoduese..... 12957
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 771, datë 4.12.2019	Për një ndryshim në vendimin nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, të ndryshuar..... 12965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 774, datë 4.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2019”, të ndryshuar..... 12965
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 775, datë 4.12.2019	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndjekjen e zbatimit të kontratës koncesionare nr. 8618, datë 14.8.2014, “Për burimin ujqor ‘Sasaj, Bunec’”, të lidhur ndërmjet ish-Ministrit të Mjedisit dhe shoqërisë “Blue Eye One” 12966
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 776, datë 4.12.2019	Për disa ndryshime në vendimin nr. 703, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit “tokë bujqësore” në “tokë urbane”, truall, të pasurisë me nr. 316, zona kadastrale 2281, Bashkia Cërrik..... 12966
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 397/1, datë 26.11.2019	Për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit (KKK) 12966
	Korrigjim gabimi teknik në vendimin nr. 752, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike’”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, viti 2019..... 12967

**VENDIM****Nr. 754, datë 30.11.2019****PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT TË
AKOMODIMIT TË PÛRKOHSHËM TË
TË DËMTUARËVE PËR SHKAK TË
FATKEQËSISË NATYRORE NË
QARQET DURRËS, TIRANË DHE
LEZHË, NË STRUKTURAT
AKOMODUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, dhe të ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të të dëmtuarve për shkak të fatkeqësisë natyrore në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, nga tërmeti i datës 26.11.2019, në strukturat akomoduese që ndodhen në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, bazuar në vendimin e Komitetit Ndërmnistror të Emergjencave Civile, sipas rregullores që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Akomodimi i përkohshëm i të dëmtuarve të bëhet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Bregdetit, me prefekturat dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse, Unionin Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqatën Shqiptare të Turizmit (ATA) si dhe subjektet private që operojnë në fushën e hoteleri-turizmit në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë.

3. Prefekturat në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë/njësitë e vetëqeverisjes vendore Durrës, Tiranë dhe Lezhë janë përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve dhe hartimin e listave përkatëse për kategorizimin e të dëmtuarve e të banesave të tyre nga tërmeti i datës 26.11.2019, sipas rregullores.

4. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, pas evidentimit nga Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) dhe Unioni Turistik Shqiptar (UTSH), përzgjedh strukturat akomoduese ku do të kryhet akomodimi i përkohshëm i të dëmtuarve.

5. AKB-ja është institucioni koordinues për verifikimin e plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate dhe për akomodimin e të dëmtuarve nëpër struktura akomoduese, bazuar në listat e hartuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore/prefektura.

6. Mbulimin e shpenzimeve të akomodimit të përkohshëm nga buxheti i shtetit, fondet e emergjencës.

7. Vetëm për strukturat akomoduese, që kanë marrëveshje/kontratë me Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, do të kryhen pagesat nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas marrëveshjes/kontratës tip, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

8. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Bregdetit, prefekturat dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore Durrës, Tiranë dhe Lezhë në zonën e prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR**Edi Rama****RREGULLORE****PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE
PËR MËNYRËN E ORGANIZIMIT MIDIS
MINISTRISË SË TURIZMIT DHE
MJEDISIT, AKB-së, PREFEKTURËS,
ORGANEVE TË VETËQEVERISJES
VENDORE PËR AKOMODIMIN E
PËRKOHSHËM TË FAMILJEVE TË
PREKURA NGA TËRMETI
I DATËS 26.11.2019****Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për mënyrën e organizimit të akomodimit të përkohshëm të familjeve të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë.

**Neni 2
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i detyrave për secilin nga institucionet/shoqatat e



përfshira në këtë proces, në funksion të akomodimit të përkohshëm dhe të sigurimit të kushteve normale të jetesës për personat e prekur nga tërmeti në strukturat akomoduese respektive.

Neni 3

Akomodimi i përkohshëm

1. Akomodimi i përkohshëm i të dëmtuarve do të bëhet në struktura akomoduese në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, sipas marrëveshjes/kontratës bashkëlidhur, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2. Akomodimi i përkohshëm *all inclusive* në strukturat akomoduese, në funksion të këtij procesi, për të dëmtuarit përfshin:

- a) fjetje;
- b) 3 (tri) vakte ushqim;
- c) drita;
- ç) ujë;
- d) ngrohje;
- dh) siguri;
- e) pastrim;
- ë) ambiente çlodhëse/rekreative (argëtuese).

3. Paga për akomodimin e përkohshëm është 2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në, sipas vendimit të Komitetit Ndërmintor të Emergjencave Civile.

4. Vlera e pagesës, sipas përcaktimit të pikës 3, të këtij neni, nuk mund të jetë më e madhe se 2 000 lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në.

5. Nëse subjekti privat shpreh pëlqimin, për shkak të situatës, të ofrojë falas akomodimin e përkohshëm për disa individë brenda strukturës së tij, Agjencia Kombëtare e Bregdetit bën zbritjen nga vlera e përgjithshme e faturës.

6. Efektet financiare, sipas këtij neni, do të përballohen nga fondet e emergjencës të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Neni 4

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe shoqatat e hoteleve

1. Unioni Turistik Shqiptar (UTSH) dhe Shoqata Shqiptare e Turizmit (ATA) evidentojnë strukturat akomoduese/hotelet të ndodhura në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, dhe listën ia përcjellin Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit.

2. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit bën përzgjedhjen e tyre bazuar në standardet cilësore të ndërtimit, vendndodhjen e tyre në zonat turistike, afërsisë me zonat e banuara, kapacitetit të akomodimit minimumi 100 persona si dhe eksperiencë bashkëpunimi me operatorë menaxhues të strukturave akomoduese.

3. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit autorizon Agjencinë Kombëtare të Bregdetit për nënshkrimin e marrëveshjes/kontratës me subjektet private që operojnë në fushën e hotelieri-turizmit në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, sipas listës së strukturave akomoduese të miratuara nga Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile.

4. Vetëm pas nënshkrimit të marrëveshjes/kontratës, subjektet private do të kompensohen nga AKB-ja, nga fondet e emergjencës të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit.

Neni 5

Detyrat e Agjencisë Kombëtare të Bregdetit

1. AKB-ja është institucioni koordinues për verifikimin e plotësimit të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kushteve të kontratës me objekt “Për akomodimin e përkohshëm të personave të prekur nga tërmeti i datës 26.11.2019, të lidhur ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Bregdetit dhe subjektit për akomodimin e të dëmtuarve nëpër struktura akomoduese, bazuar në listat e hartuara nga njësi e vetëqeverisjes vendore ose prefektura dhe pasi të jetë përgatitur dosja personale për çdo individ të dëmtuar.

2. Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) nënshkruan marrëveshje/kontratë të veçantë me secilën strukturë akomoduese, të përzgjedhur, që do të sigurojë akomodimin e përkohshëm të të dëmtuarve nga tërmeti.

3. Dosja personale për çdo individ të dëmtuar përgatitet nga AKB-ja, sipas dokumenteve të listuara në shtojcën 1, të kësaj rregulloreje.

4. Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas kategorive të ndara nga ana e organeve të vetëqeverisjes vendore, bazuar në përcaktimet e bëra në nenin 6, të kësaj rregulloreje, do të marrë përsipër mbulimin e shpenzimeve me fondet e emergjencës nga buxheti i shtetit.

5. Agjencia Kombëtare e Bregdetit do të kryejë shpërndarjen e të dëmtuarve nëpër strukturat akomoduese të miratuara.



Neni 6

Detyrat e njësisë së vetëqeverisjes vendore ose prefekturës

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose prefektura ka si detyrë kryesore të kryejë evidentimin dhe verifikimin e të dëmtuarve nga tërmeti, si dhe të banesave të tyre, duke i kategorizuar, si më poshtë vijon:

- a) banesa të shembura;
- b) banesa të dëmtuara rëndë;
- c) banesa të pabanueshme.

2. Të dëmtuarit që i përkasin kategorisë së përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të këtij neni, do të strehohen me prioritet nëpër strukturat akomoduese, të përzgjedhura, deri në datën 31 mars 2020.

3. Të dëmtuarit që i përkasin kategorive të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, do të strehohen në strukturat akomoduese, të përzgjedhura, deri në momentin që do të rregullohet banesa e tyre. Maksimumi i akomodimit të tyre do të jetë deri në datën 31 mars 2020.

4. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose prefektura është përgjegjëse për kryerjen e verifikimeve dhe hartimin e listave përkatëse për të dëmtuarit si dhe kategorizimin e banesave të tyre, sipas kategorive më sipër. Njësia e vetëqeverisjes vendore lëshon vërtetimin që individ i dëmtuar është banor i kësaj njësie dhe që banesa e tij përfshihet në kategorinë e banesave, të përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 6, të kësaj

rregulloreje, të shoqëruar me fotografi të banesës së dëmtuar.

5. Transporti nga njësia akomoduese nëpër shkolla dhe vendet e punës do të mbulohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore përkatëse.

6. Individët e dëmtuar, që përfitojnë strehim të përkohshëm nëpër struktura akomoduese duhet të plotësojnë një vetëdeklarim sipas modelit bashkëlidhur, shtojca 2, e cila do të jetë pjesë përbërëse e dosjes personale.

SHTOJCA 1

Lista e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja personale e çdo individ të dëmtuar nga tërmeti i datës 26.11.2019

1. Vërtetim nga njësia e vetëqeverisjes vendore që individ i dëmtuar është banor i kësaj njësie dhe që banesa e tij përfshihet në kategorinë e banesave të përcaktuara në pikës 1, të nenit 6, të kësaj rregulloreje, të shoqëruar me fotografi të banesës së dëmtuar.

2. Kopje të kartës së identitetit të individit të dëmtuar ose certifikatë personale.

3. Formularin e vetëdeklarimit nga përfituesi i strehimit të përkohshëm, sipas formatit bashkëlidhur.

4. Në rastin e familjeve me shumë anëtarë, dokumentacioni i mësipërm paraqitet nga kryefamiljari, shoqëruar me certifikatën familjare për personat që ka në ngarkim.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETTIT

Nr. _____prot.

Datë _____.____.2019

SUBJEKTI _____

Nr. _____prot.

Datë _____.____.201__

MARRËVESHJE/KONTRATË
PËR AKOMODIMIN E PËRKOHSHËM, *ALL INCLUSIVE*
TË PERSONAVE TË PREKUR NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019
NDËRMJET
AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

DHE

SUBJEKTIT _____

Agjencia Kombëtare e Bregdetit: institucion publik, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, me adresë: bulevardi “Gjergj Fishta”, Pallatet Shallvare, Tiranë, Shqipëri, me numër unik identifikimi NUIS L41417451U, përfaqësuar ligjërisht në këtë marrëveshje/kontratë (këtu e në vijim “kontrata”) nga **z. Ledion Lako**, drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (më poshtë referuar si “AKB”).

dhe

Subjektit _____, përfaqësuar nga _____, me
NIPT _____, me adresë _____,
të dyja së bashku referuar si “PALËT”,

Bazuar në gjendjen e fatkeqësisë natyrore në qarqet Tiranë, Durrës dhe Lezhë, të shpallur me vendimin nr. 750, datë 27.11.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si pasojë e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qarqet Durrës, Lezhë, Tiranë.

- Bazuar në dispozitat e ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, e ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social”, si dhe:

- duke parë nevojën për bashkëpunim dhe mirëkuptim dypalësh, në mbështetje të personave të prekur rëndë dhe të mbetur pa strehim nga tërmeti i datës 26.11.2019, në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, dhe në mirëkuptim të plotë me njëri-tjetrin, vendosën të hartojnë dhe të nënshkruajnë këtë kontratë, si më poshtë vijon:

Neni I

Parime të përgjithshme

1. Kjo kontratë synon sigurimin e ndihmës reciproke për përballimin e nevojave për akomodim, *all inclusive* (përfshirë strehim dhe ushqim) të personave të prekur rëndë dhe të mbetur pa strehim nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë.

2. AKB-ja është institucioni koordinues për verifikimin e plotësisë së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i kësaj kontrate dhe për akomodimin e të dëmtuarve nëpër struktura akomoduese, bazuar në lisat e hartuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose prefektura.



3. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose prefektura është përgjegjës për kryerjen e verifikimeve dhe hartimin e listave përkatëse për kategorizimin e të dëmtuarve si dhe të banesave të tyre si të pabanueshme, nga tërmeti i datës 26.11.2019.

4. Subjekti _____ është përgjegjës për ofrimin e akomodimit (përfshirë strehim dhe ushqim) për numrin e dakordësuar të personave sipas specifikimeve të kësaj kontrate.

Neni 2

Objekti i kontratës

Objekti i kësaj kontrate është garantimi i akomodimit *all inclusive* (përfshirë strehimin dhe ushqimin) të personave të prekur rëndë dhe të mbetur pa strehim nga tërmeti i datës 26.11.2019 në qarqet Durrës, Lezhë dhe Tiranë, sipas listës bashkëlidhur kësaj kontrate, e cila është objekt integral i kontratës dhe përditësohet vetëm me kërkesë të AKB-së.

Neni 3

Kohëzgjatja

1. Kjo kontratë e lidhur midis AKB-së dhe subjektit për një periudhë kohore _____ deri _____ muaj, dhe i fillon efektet e saj ligjore në datën _____ dhe do të vijojë deri në datën _____ (me afat maksimal deri në datën 31.3.2020).

2. Në rast se individëve të dëmtuar të akomoduar përkohësisht në strukturat akomoduese i sigurohet strehim në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi nga Enti Kombëtar i Banesave ose nga çdo institucion tjetër shtetëror, kontrata mund të zgjidhet para afatit, sipas parashikimit të këtij neni, me kërkesë të AKB-së, duke e njoftuar me shkrim palën tjetër, brenda 5 ditëve përpara zgjidhjes.

Neni 4

Pagesa

Pagesa për akomodimin e përkohshëm të individëve të dëmtuar nga tërmeti është 2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person, përfshirë TVSH-në, pjesë e listës bashkëlidhur kësaj kontrate dhe përfshin strehimin, ushqimin për të tria vaktet, ngrohje dhe të gjitha shërbimet e tjera, përfshirë detyrimin ligjor për likuidimin mujor të energjisë elektrike dhe të ujësjellësit për gjatë gjithë periudhës që do të zgjasë kjo kontratë.

Neni 5

Kushtet e pagesës

1. AKB-ja do t'i paguajë subjektit _____ vlerën 2 000 (dy mijë) lekë në ditë, për person, përfshirë TVSH-në, sipas listës bashkëlidhur të dakordësuar në këtë kontratë, e cila rishikohet, sipas faturës së lëshuar nga subjekti.

2. Fatura shoqërohet me listëprezencat ditore të firmosura nga punonjësi i autorizuar i strukturës akomoduese dhe individi i dëmtuar.

3. Kjo vlerë mbetet e pandryshuar për gjatë gjithë kohës që do të zgjasë kjo kontratë.

4. Pagesa do të bëhet çdo datë 5 dhe 20 të muajit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë kontratë, në Bankën _____ me IBAN _____.

5. Efektet financiare për zbatimin e kësaj kontrate do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit, fondet e emergjencës.



Neni 6

Të drejtat dhe detyrimet e AKB-së

1. AKB-ja ka detyrimin të koordinojë gjithë procesin e akomodimit të përkohshëm me subjektin _____.
2. AKB-ja është e detyruar të paguajë në masën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë për të gjithë individët e strehuar në strukturën akomoduese, bazuar në listat e konfirmuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose prefektuara si dhe listëprezencat ditore të firmosura nga punonjësi i autorizuar i strukturës akomoduese dhe individ i dëmtuar.
3. AKB-ja ka detyrimin të raportojë pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit mbi numrin e personave/individëve të akomoduar përkohësisht në strukturën akomoduese.
4. AKB-ja duhet të plotësojë dosjen personale për çdo individ të dëmtuar, sipas dokumenteve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
5. Personat e autorizuar nga drejtori i Përgjithshëm i AKB-së do të verifikojnë listat emërore dhe gjendjen e të strehuarve, çdo ditë, dhe do të hartojnë një procesverbal i cili do të firmoset nga të dyja palët. Ky procesverbal i përcillet drejtorit të Përgjithshëm të AKB-së lidhur me situatën.
6. AKB-ja përcjell pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, çdo javë, një raport përmbledhës mbi kushtet e jetesës dhe të ushqimeve për të strehuarit.
7. AKB-ja do të njoftojë subjektin për zgjidhjen e kontratës para afatit në rastin e parashikuar në pikën 2, të nenit 3.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet të subjektit _____

1. Subjekti _____, menjëherë me nënshkrimin e kësaj kontrate, duhet të strehojë individët e prekur nga tërmeti, sipas listës bashkëlidhur, në dhomat e strukturës akomoduese që disponon, duke i siguruar kushte normale jetese, ujë, drita, ngrohje, siguri, pastrim dhe ambiente çlodhëse/rekreative (argëtuese).
2. Subjekti _____ duhet të garantojë ushqimin për individët e prekur nga tërmeti, për të tria vaktet në të gjitha ditët e qëndrimit kundrejt vlerës së pagesës të dakordësuar mes palëve, sipas modelit të menisë bashkëlidhur kësaj kontrate.
3. Subjekti _____ duhet të paguajë të gjitha detyrimet kundrejt shtetit për pagimin e energjisë elektrike, ujë, detyrimet mujore për ambientet e përbashkëta etj.
4. Subjekti _____ merr përsipër mirëmbajtjen dhe pastrimin e sipërfaqes ku janë vendosur të strehuarit.
5. Subjekti _____ garanton AKB-në që struktura akomoduese është në posedim të rregullt ligjor dhe e ushtron atë në mënyrë të ligjshme.
6. Subjekti _____ nuk ka të drejtë ta kërkojë zgjidhjen e kontratës përpara afatit të përcaktuar në kontratë.
7. Subjekti zgjidh kontratën para afatit në rastin e parashikuar në pikën 2, të nenit 3, kur njoftohet nga AKB-ja.

Neni 8

Dispozita përfundimtare

1. Për dëmtime të qëllimshme të ambienteve dhe pajisjeve të vëna në dispozicion për të strehuarit, do të përgjigjet personalisht i strehuari sipas marrëveshjes së lidhur midis tij dhe subjektit _____.
2. Ngarkohen Agjencia Kombëtare e Bregdetit dhe subjekti _____ për zbatimin e kësaj kontrate.
3. Çdo rregullim ose ndryshim në këtë kontratë mund të kryhet vetëm nëpërmjet pëlqimit reciprok të palëve.



4. Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj kontrate zgjidhet me mirëkuptim midis palëve.

Neni 9
Hyrja në fuqi

1. Kjo kontratë do të jetë në fuqi në përputhje me përcaktimet e nenit 3, të kësaj kontrate.
2. Kjo kontratë hartohet në 4 (katër) kopje, nga të cilat një kopje depozitohet në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, 2 (dy) kopje mbahen nga AKB-ja dhe një kopje nga subjekti.

Nënshkruar, sot më ____/____/2019.

Palët:

AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT
LEDION LAKODREJTOR I PËRGJITHSHËM

SUBJEKTI

ANEKSI I

Menyja ditore e ushqimit:

- 3 vakte të përfshira në çmimin e përcaktuar në këtë kontratë;

Mëngjesi përfshin: _____

Dreka përfshin: _____

Darka përfshin: _____

Oraret e shërbimit të tri vakteve:

- mëngjesi, orari 07:00-10:00

- dreka, orari 13:00-15:30

- darka, orari 19:00-21:00

ANEKSI II
MIRËMBAJTJA DHE ORARET E PASTRIMIT TË AMBIENTEVE TË STREHIMIT NGA ANA
E SUBJEKTT _____

ANEKSI III
DOSJA PERSONALE IDENTIFIKUESE E ÇDO INDIVIDIT OSE FAMILJES SË DËMTUAR TË
AKOMODUAR PËRKOHËSISHT



MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E BREGDETIT

FORMULAR VETËDEKLARIMI
PËR TË PREKURIT NGA TËRMETI I DATËS 26.11.2019, PËR QËLLIM STREHIMI TË
PËRKOHSHËM NË HOTELE
për t'u plotësuar nga kryefamiljari

A. INFORMACIONE PERSONALE

Nr.	Emër	Atësi	Mbiemër	ID / certifikatë	Datëlindje	Statusi familjar
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						

B. INFORMACIONI MBI BANESËN

Qyteti	Njësia vendore	Lagjja	Rruga	Nr.	Detaje

Statusi i Banesës

E PËRDORSHME <i>Dëmtime sipërfaqësore</i>	PËRKOHËSISHT E PËRDORSHME <i>Dëmtime të rëndësishme lokale</i>	E RREZIKUAR <i>Dëmtime strukturore të pariparueshme</i>

Dokumenti i inspektimit nga Bashkia

Datë	Nr. prot.	Grupi i inspektimit të Bashkisë	Titullari (që ka firmosur)

C. INFORMACION MBI STREHIMIN E PËRKOHSHËM

Hoteli	Zona	Dhoma nr.	Persona të strehuar	Data e fillimit të akomodimit	Data e largimit nga hoteli

** Deklaroj dhe pranoj se të dhënat e mësipërme janë të sakta dhe të vërteta, dhe në rast se vërtetohet ndryshe mbaj çdo përgjegjësi ligjore për deklarimin e dhënë.*

Vetëdeklaruesi (Kryefamiljari)

Emër Atësi Mbiemër _____

Firmë _____

Telefon _____



VENDIM

Nr. 771, datë 4.12.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN
NR. 926, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR KRITERET E
VLERËSIMIT TË PRONËS
SHTETËRORE QË PRIVATIZOHET
APO TRANSFORMOHET DHE
PROCEDURËN E SHITJES”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2, të aktit normativ nr. 4, datë 9.7.2008, “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim të shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore, të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, miratuar me ligjin nr. 9967, datë 24.7.2008, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Shkronja “a”, e pikës 25, e kreut të III-të, “Procedura e shitjes së pronës shtetërore”, e vendimit nr. 926, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Për shitjen e objektit (mjete kryesore, mjete xhiroje etj.) 100 (njëqind) për qind e vlerës së shitjes i kalon buxhetit të shtetit.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 774, datë 4.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 128, DATË 13.3.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN
E KRITEREVE BAZË, TË SEKTORËVE
QË DO TË MBËSHTETEN DHE TË
MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I
PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE
ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2019”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, dhe 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, “Për peshkimin”, të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, në shkronjën “a”, vlera “495 000 000 (katërqind e nëntëdhjetë e pesë milionë) lekë” zëvendësohet me “551 992 000 (pesëqind e pesëdhjetë e një milionë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë”, ndërsa në shkronjën “c”, vlera “84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekë” zëvendësohet me “284 000 000 (dyqind e tetëdhjetë e katër milionë) lekë”.

b) Në pikën 6, në shkronjën “a”, vlera “83 000 000 (tetëdhjetë e tre milionë) lekë” zëvendësohet me “74 243 822 (shtatëdhjetë e katër milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e tetëqind e njëzet e dy) lekë”, ndërsa në shkronjën “b”, vlera “2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë” zëvendësohet me “1 779 800 (një milion e shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind) lekë”.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 775, datë 4.12.2019

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT
KONTRAKTUES PËR NDJEKJEN E
ZBATIMIT TË KONTRATËS
KONCESIONARE NR. 8618, DATË
14.8.2014, “PËR BURIMIN UJOR ‘SASAJ,
BUNEC’”, TË LIDHUR NDËRMJET
ISH-MINISTRISË SË MJEDISIT DHE
SHOQËRISË “BLUE EYE ONE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural si të vetmin autoritet kontraktues për ndjekjen e zbatimit të kontratës koncesionare nr. 8618, datë 14.8.2014, “Për burimin ujor ‘Sasaj, Bunec’”, të lidhur ndërmjet ish-Ministrisë së Mjedisit dhe shoqërisë “Blue Eye One”.

2. Ndjekja e zbatimit të kontratës koncesionare do të bëhet nëpërmjet Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, e cila do të raportojë në vazhdimësi tek autoriteti kontraktues dhe do t'i propozojë atij kryerjen e veprimeve procedurale, që do të duhet të ndërmerren gjatë zbatimit të kontratës, si dhe marrjen e masave në rast shkeljeje.

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia për Menaxhimin e Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 776, datë 4.12.2019

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 703, DATË 30.10.2019, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
NDRYSHIMIT TË STATUSIT, NGA
KATEGORIA E RESURISIT “TOKË
BUJQËSORE” NË “TOKË URBANE”,
TRUALL, TË PASURISË ME NR. 316,
ZONA KADASTRALE 2281,
BASHKIA ÇËRRIK**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5/2, të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 703, datë 30.10.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në titull dhe kudo në tekstin e vendimit, fjalët “... të pasurisë me nr. 316 ...” zëvendësohen me “... të pasurisë me nr. 316/1, volum 15, faqe 136 ...”.

2. Në lidhjen nr. 1, në kolonën me emërtimin “Numri i pasurisë”, rreshti 1, referenca “... 316 ...” zëvendësohet me “... 316/1, volum 15, faqe 136 ...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR
Nr. 397/1, datë 26.11.2019

**PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË
KËSHILLIT KOMBËTAR
TË KONTABILITETIT (KKK)**

Në mbështetje të nenit 25, pika 2, të ligjit nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 505, datë 17.7.2019, “Për miratimin e rregullores së organizimit dhe të funksionimit të



Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”, ministri i Financave dhe Ekonomisë

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, si më poshtë vijon:

- dy anëtarë të propozuar nga shoqatat profesionale të kontabilitetit dhe dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose të njësive ekonomike me interes publik) ose nga shoqata e bankave:

1) Znj. Ingrid Shuli (propozuar nga shoqatat profesionale të kontabilitetit) anëtare;

2) Znj. Vjollca Karapici (propozuar nga dhomat e tregtisë (përfaqësues të njësive ekonomike të mëdha ose të njësive ekonomike me interes publik ose nga shoqata e bankave) anëtare;

- tre anëtarë të propozuar nga ministria përgjegjëse për financat:

1) Znj. Alma Beja anëtare;

2) Znj. Greta Angjeli anëtare;

3) Z. Fatos Beqja anëtar;

- një anëtar të propozuar nga organizata profesionale e audituesve ligjorë:

1) Znj. Eleonora Olli (Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar të Shqipërisë) anëtare.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

KORRIGJIM GABIMI TEKNIK

Në vendimin nr. 752, datë 30.11.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për një shtesë në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, ‘Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike””, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 162, viti 2019, në pikën 1 të vendimit, e cila shton pikën 31.1, bëhet korrigjimi si më poshtë:

fjala **“Përjashtimisht”** të zëvendësohet me fjalën **“Vetëm”**.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë